

VENDIM
Nr.708, datë 12.10.2011

PËR MIRATIMIN E MANUALEVE TEKNIKE TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË
NDËRTIMIT DHE TË ANALIZAVE TEKNIKE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi, të cilat do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të dërgojë të dhënat për çmimet mesatare të tregut të katër elementeve të strukturës së kostos, të nevojshme për përditësimin e çmimeve të manualit.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve vë në dispozicion çmimet e “investiguara” në bazë të kërkesës së bërë nga MPPT-ja, brenda tre muajve nga kërkesa e tyre.

4. Çmimet e zërave të punimeve, të përcaktuara në manualet teknike, janë orientuese dhe referuese për planifikimin e buxhetit vjetor.

5. Vendimi nr.1027, datë 15.12.2010 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha